



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3181

NR. VENDIMI 2578



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr.2262/3181 Regj Them

Nr.2578

Vendimi

Dt.09.09.2021/Dt.05.10.2021

Dt.05.10.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS “

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

GJYQTAR

GERD HOXHA

asistuar prej sekretares gjyqësore **Znj.Juna Sanxhaku**, sot më datë **05 tetor 2021**, me kërkesën e **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori **Z.Sokol Malaj**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale nr.2262/3181 akti, në ngarkim të ;

Të pandehurit : **Xhulio Llaka**, i biri i Pëllumb dhe i Merita, i dtl.28.04.1995, lindur në Mallakastër dhe banues në Tiranë, Rruga “Ali Demi”, përballë me bar kafe “Oslo”, shqiptar, beqar, arsimit mesëm, gjykuar me masë sigurimi “*detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, i mbrojtur nga mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata *Av.Edvis Gorishti*.

Akuzuar : Për veprën penale të “*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Në përfundim të hetimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi provat shkresore; dëgjoji prokurorin, i cili kërkoi përfundimisht:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhulio Llaka** për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244 i K.Penal dhe dënimin e tij me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
- Aplikim e nenit 59 të K.Penal dhe në bazë të tij vënien në provë të të pandehurit për një periudhë kohe prej **8 (tetë) muajsh**.

- Pagimin e shpenzimeve procedurale nga i pandehuri.

Dëgjoi avokatin dhe të pandehurin Xhulio Llaka, të cilët kërkuan deklarinim fajtor të pandehurit, duke shprehur pendim të thellë për kryerjen e veprës penale si dhe duke u shprehur është dakort me kërkesën e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit.

si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi ;

V Ë R E N

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Xhulio Llaka, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Në seancën paraprake, i pandehuri Xhulio Llaka, nuk paraqiti asnjë kërkesë dhe/apo pretendim në lidhje me pavlefshmërinë e akteve, papërdorshmërinë e provave apo nevojën për të marr prova të tjera. Gjithashtu i pandehuri nuk ka kërkuar të bëjë deklarinime apo të pyetet. I pandehuri bazuar në nenet 332/c dhe 403 të K.Pr.Penale bëri kërkesë për procedimin me gjykim të shkurtuar, e cila nuk u kundërshtua nga organi i akuzës. Në lidhje me këtë kërkesë Gjykata pasi studioi aktet e paraqitura nga Prokuroria në fashikullin e gjykimit, bazuar në nenin 405 të K.Pr.Penale çmoi se, kërkesa duhej pranuar pasi, çështja mund të zgjidhet në gjendjen, në të cilën ndodhen aktet duke proceduar më tej me këtë lloj gjykimi.

Nga administrimi që i’u bënë akteve shkresore të ndodhura në dosje rezultoi i provuar fakti se, i pandehuri Xhulio Llaka ka konsumuar plotësisht me dashje, veprën penale të “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se më datë 09.07.2021 në orën 20:30, është dhënë njoftim në sallën operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, se punonjësit e qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë kanë kapur në flagrancë të pandehurin Xhulio Llaka, për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244 I K.Penal.

Më konkretisht, nga shqyrtimi gjyqësor i akteve të ndodhura në fashikullin për gjykim rezultoi se, në datë 09.07.2021 punonjësi i qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, shtetasi Arben Mani, ka qenë i planizuar trup shërbimi autopratullë, turni i dytë (ora 12:00-22:00) me kod shërbimi 82/28, në kontroll territori. Ai dhe kolegët e tij Xhavit Shabani, Artur Dhimitri dhe Arbër Sula, kanë qenë të vendosur pikë kontrolli në vendin e quajtur "Flamuri gjerman", në rrugën "Ali Demi". I pandehuri Xhulio Llaka që po vinte në zbritje për në hyrje të qytetit është konstatuar, që qarkullonte me mjet, pa vendosur rripin e sigurimit.

Punonjësi i policisë i ka bërë shenjë ndalimi, duke e pozicionuar në anën e djathtë të karaxhatës. Pasi mjeti ka ndaluar, punonjësi i policisë i është afruar duke komunikuar shkakun e ndalimit - qarkullimi pa vendosur rripin e sigurimit. Më pas, ai i ka kërkuar dokumentacionin e mjetit. I pandehuri, si fillim merr vetëm lejen e qarkullimit nga kroskoti dhe i thotë që “*të jap një kafe dhe më lër të iki*”. Arbeni përsëri i ka kërkuar vetëm anën dokumentare të mjetit, por i pandehuri ka insistuar për të disatën herë me shprehjen “*merr pi një kafe*” dhe më pas, i ka future një kartëmonedhë me preje 2000 lekëshe në lejen e qarkullimit.

Në këtë moment Arbeni i ka thënë : ”*pse e bëre këtë për tju shmangur masës së gjobës?*”. I pandehuri në këtë moment ka zgjatur dorën për tja marrë nga dora sëbashku me lejen e qarkullimit, por nuk i ka marrë dot. Nga kontrolli i dokumentacionit të mjetit rezultoi s,e siguracioni i mjetit kishte mbaruar dhe dilte në sistem pa siguracion.

Të gjitha veprimet e punonjësit të policisë janë monitoruar me kamerën e trupit të kolegut të tij Xhavit Shabani me nr."032". Ai ka përpiluar procesverbalin e konstatimit të shkeljes me numër 2107090480 datë 09.07.2021 ora 18:29 për nenin 170 pika 8 dhe nenin 191 pika 1 dhe 2, procesverbalin e kapjes në flagrante të shtetasit dhe raportin e shërbimit.

I pyetur në cilësinë e personi që ka dijeni për rrethanat e hetimit, shtetasi Xhavit Shabanaj pohon thëniet e kolegut të tij Arben Mani dhe shton se, kamera e tij e trupit ka probleme teknike dhe e ka të vështirë që ti shkarkojë pamjet, por do ti vejë në dispozicion sapo ti ketë gati. Ai shton se ka bërë rregjistrim edhe me anë të telefonit të tij.

Nga ana e Prokurorisë u sekustrua në cilësinë e provës materiale një kartmonedhë e prerjes 2000 (dy mijë) lekë të reja me numër serie numer serie QF492695.

Nga OPGJ është pyetur në cilësinë e personit në hetim shtetasi Xhulio Llaka, i cili për sa është pyetur ka deklaruar se : “*po lëvizte me makinën e një shoku që ja kishte lënë në përdorim për sot me qëllim për ta çuar në oficinë për riparimin dhe luçidimin e disa dëmtimeve që kishte. Është ndaluar nga punonjësi i policisë i cili i ka kërkuar patentën dhe dokumentat e mjetit, pasi ishte pa rrip sigurimi. Ai ka kërkuar dokumentat e mjetit në kroskotin e makinës dhe i ka nxjerrë për të ja dhënë punonjësit të policisë. Kur ja ka dhënë ka parë që në lejën e qarkullimit ishte edhe një kartmonedhë 2000 lekëshe për të cilën Xhulio sqaron se nuk kishte dijeni se ishte aty pasi mjeti nuk është i tij dhe nuk e dinte se çfarë kishin brenda letrat. Në atë moment është munduar që ta marr mbapsh kartmonedhën, por punonjësi i policies nuk e ka lejuar dhe më pas është shoqëruar në ambjentet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë”.*

Nisur nga sa më sipër, bazuar në tërësinë e rrethanave të cituara më sipër, Prokuroria pretendon se, provohet plotësisht që i pandehuri Xhulio Llaka me veprimet e tij active, të kundërligjshme, në trajtën e dhënies së një shume të hollash punonjësit të policisë rrugore, në Tiranë, me qëllim që ky i fundit të mos kryente detyrën e tij port ë favorizonte të pandehurin, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Në këto kushte, në diskutimin përfundimtar organi i akuzës kërkoi deklarinimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit Xhulio Llaka për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244 i K.Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Bazuar në rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe personalitetin e të pandehurit, prokurori kërkoi aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe në bazë të tij vënien në provë të të pandehurit për një periudhë kohe prej 8 (tetë) muajsh.

Gjatë gjykimit i pandehuri Xhulio Llaka personalisht pranoi se, e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri është i penduar dhe ka kërkuar falje për veprimin e klryer prej tij, duke deklaruar se është dakort me kërkesën e prokurorit për llojin dhe masën e dënimin.

Faktet e mësipërme u vërtetuan nga: informacion për referimin e veprës penale datë 09.07.2021; procesverbal i kapjes në flagrancë të shtetasit datë 09.07.2021; procesverbal për kallëzimin e veprës penale datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi nga ana e shtetasit Arben Mani datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi nga ana e shtetasit Xhavit Shabanaj datë

09.07.2021; procesverbal kqyrje dhe marrje prova shkresore datë 09.07.2021; procesverbal sekuestrimi prove materiale datë 09.07.2021; Vendim vleftësim sekuestro datë 11.07.2021; kontrolli banese datë 04.02.2021; procesverbal kqyrje automjeti datë 03.02.2021; procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Xhulio Llaka datë 09.07.2021; procesverbal mbi kontrollin personal të shtetasit Xhulio Llaka datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi si person ndaj të cilit zhvillohen hetime për shtetasin Xhulio Llaka datë 09.07.2021 ; procesverbal i pyetjes së të pandehurit datë 19.07.2021 ; si dhe në tërësi aktet e procedimit penal nr. 5008 të vitit 2021.

Sa i përket kualifikimit ligjor të veprimeve të kryera më sipër nga i pandehuri Gjykata vëren se, do t'i referohet këtyre dispozitave ligjore :

- nenit 152 të K.Pr.Penale i cili parashikon: *“Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.”*
- nenit 244/1 të K.Penal, i ndryshuar me ligjin nr.43/2021, i cili parashikon se : *“Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtëpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjastë muaj deri në një vit. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”*

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç janë ato të vendosura nga shteti për të siguruar funksionimin normal të institucioneve shtetërore, autoritetin dhe korrektësinë e personave që ushtrorjnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetit dhe të shtetasve, nga veprime apo mosveprime kriminale. Ky është edhe objekti i kësaj vepre penale. Sipas nenit 244 të K.Penal, që të ekzistojë vepra penale parashikuar nga kjo dispozite duhet që :

- **nga ana objektive**, autori i veprës penale të ndërmarrë me dashje veprime aktive të kundërligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat konsistojnë në a) premtimin, propozimin ose dhënien e çdo lloji përfitimi të parregullt (**mita**) në favor të personit që ushtron funksione publike apo për pasona të tjerë, të lidhur me të. Pas ndryshimeve të kësaj dispozite sipas paragrafit të parë nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të ketë dhënë mitë në shumën deri në 50.000 lekë. Do të konsiderohet **“Mite”** çdo lloji përfitimi i parregullt material ose jo material, i cili sipas rastit konkret nuk i takon t'i jepet personit që ushtron funksione publike.; b) premtimi, propozimi apo dhënia si më sipër bëhet me qëllim kryerjen apo moskryerjen e një veprimi, që ka lidhje me detyrën apo funksionin e tij publik. Premtimi, propozimi apo marrja e mites mund të bëhen drejtëpërdrejtë apo tërthorazi, nëpërmjet personave të tjerë. Mitdhënësi, me anë të veprimeve të tij, i lë të kuptojë personit që ushtron funksionin publik që, ai kërkon t'a paguajë për të përfituar kryerjen apo moskryerjen e veprimeve që ai (mitëdhënësi) dëshiron. Premtimi, propozimi apo dhënia mund të bëhet para, gjatë apo pas kryerjes së veprimit apo mosveprimit nga funksionari publik. Sipas Konventes *“Mbi*

Korrupsionin” miratuar në Strasburg në vitin 1999 rezulton se, “*Mitëdhënësi është i gatshëm për të dhënë përfitimin e padrejtë në çdo moment.*” Gjithashtu, sipas nenit 244 të K.Penal vepra penale quhet e konsumuar edhe nëse funksionari publik nuk e ka kryer veprimin e dëshiruar nga mitdhënësi, megjithëse ky i fundit i’ a ka premtuar, propozuar apo i’ a ka dhënë mitën, d.m.th krimi quhet i kryer që nga çasti i paraqitjes së premtimit apo propozimit.

- **subjekti** i veprës penale të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra të jetë mbi 14 vjeç. **Subjekti aktiv i kësaj dispozite është i përgjithshëm. Ndërsa, subjekti pasiv i saj është i posaçëm** - një shtetas, mbi 14 vjeç, që ushtron detyrën e një funksionari publik, të cilit i kërkohet t’ a përdorë këtë cilësi për të vepruar në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e rregullt të detyrës, që i është ngarkuar. Ligji nuk e përcakton se, cilët persona futen në kategorinë e personave që kryejnë funksione publike. Për këtë qëllim i duhet referuar kritereve të përcaktuara në Konventen “*Mbi Korrupsionin*” të miratuar në vitin 1999 në Strasburg (*e cila i përcakton me termin “nëpunës të administratës publike”*), Ligjit shqiptar “*Për statusin e nëpunësit civil*”, teorisë së të drejtës penale shqiptare dhe asaj të huaj si dhe praktikës gjyqësore. Si përfundim mund të thuhet se si rregull, *punonjës publik do të kategorizohet çdo person, të cilit veprimtaria e punës së tij të përditëshme të rregullohet nga normat e së drejtës publike, është shprehje e vullnetit administrativ dhe materializohet në kompetenca autoritare, provuese ose në lëshimin e autorizimeve, licencave apo dokumentave të tjera vërtetuese.*
- **nga ana subjektive**, krimi kryhet vetëm me dashje dhe asnjëherë nga pakujdesia, me qëllim krijimin e avantazheve materiale apo jomateriale për vete ose për të tjerë.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi gjyqësor i akteve të ndodhura në fashikullin për gjykim rezultoi se, në datë 09.07.2021 punonjësi i qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, shtetasi Arben Mani, ka qenë i planizuar trup shërbimi autopratullë, turni i dytë (ora 12:00-22:00) me kod shërbimi 82/28, në kontroll territori. Ai dhe kolegët e tij Xhavit Shabani, Artur Dhimitri dhe Arbër Sula, kanë qenë të vendosur pikë kontrolli në vendin e quajtur "Flamuri gjerman", në rrugën "Ali Demi". I pandehuri Xhulio Llaka që po vinte në zbritje për në hyrje të qytetit është konstatuar, që qarkullonte me mjet, pa vendosur rripin e sigurimit.

Punonjësi i policisë i ka bërë shenjë ndalimi, duke e pozicionuar në anën e djathtë të karaxhatës. Pasi mjeti ka ndaluar, punonjësi i policisë i është afruar duke komunikuar shkaku e ndalimit - qarkullimi pa vendosur rripin e sigurimit. Më pas, ai i ka kërkuar dokumentacionin e mjetit. I pandehuri, si fillim merr vetëm lejen e qarkullimit nga kroskoti dhe i thotë që "*të jap një kafe dhe më lër të iki*". Arbeni përsëri i ka kërkuar vetëm anën dokumentare të mjetit, por i pandehuri ka insistuar për të disatën herë me shprehjen “merr pi një kafe” dhe më pas, i ka future një kartëmonedhë me preje 2000 lekëshe në lejen e qarkullimit.

Në këtë moment Arbeni i ka thënë : "*pse e bërë këtë për tju shmangur masës së gjobës?*". I pandehuri në këtë moment ka zgjatur dorën për tja marrë nga dora sëbashku me lejen e qarkullimit, por nuk i ka marrë dot. Nga kontrolli i dokumentacionit të mjetit rezultoi s,e siguracioni i mjetit kishte mbaruar dhe dilte në sistem pa siguracion.

Të gjitha veprimet e punonjësit të policisë janë monitoruar me kamerën e trupit të

kolegut të tij Xhavit Shabani me nr."032". Ai ka përpiluar procesverbalin e konstatimit të shkeljes me numër 2107090480 datë 09.07.2021 ora 18:29 për nenin 170 pika 8 dhe nenin 191 pika 1 dhe 2, procesverbalin e kapjes në flagrance të shtetasit dhe raportin e shërbimit.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, shtetasi Xhavit Shabanaj pohon thëniet e kolegut të tij Arben Mani dhe shton se, kamera e tij e trupit ka probleme teknike dhe e ka të vështirë që ti shkarkojë pamjet, por do ti vejë në dispozicion sapo ti ketë gati. Ai shton se ka bërë rregjistrim edhe me anë të telefonit të tij.

Nga ana e Prokurorisë u sekustrua në cilësinë e provës materiale një kartmonedhë e prerjes 2000 (dy mijë) lekë të reja me numër serie numer serie QF492695.

Nga OPGJ është pyetur në cilësinë e personit në hetim shtetasi Xhulio Llaka, i cili për sa është pyetur ka deklaruar se :*“po lëvizte me makinën e një shoku që ja kishte lënë në përdorim për sot me qëllim për ta çuar në oficinë për riparimin dhe luçidimin e disa dëmtimeve që kishte. Është ndaluar nga punonjësi i policisë i cili i ka kërkuar patentën dhe dokumentat e mjetit, pasi ishte pa rrip sigurimi. Ai ka kërkuar dokumentat e mjetit në kroskotin e makinës dhe i ka nxjerrë për të ja dhënë punonjësit të policisë. Kur ja ka dhënë ka parë që në lejën e qarkullimit ishte edhe një kartëmonedhë 2000 lekëshe për të cilën Xhulio sqaron se nuk kishte dijeni se ishte aty pasi mjeti nuk është i tij dhe nuk e dinte se çfarë kishin brenda letrat. Në atë moment është munduar që ta marr mbapsh kartëmonedhën, por punonjësi i policies nuk e ka lejuar dhe më pas është shoqëruar në ambjentet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë”*.

Gjatë gjykimit i pandehuri Xhulio Llaka personalisht pranoi se, e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri është i penduar dhe ka kërkuar falje për veprimin e klryer prej tij, duke deklaruar se është dakort me kërkesën e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit.

Nga analiza e të gjithë provave të administruara gjatë këtij gjykimi Gjykata vlerëson se, në një proces penal, organi i Prokurorisë ka barrën e provës dhe detyrimin ligjor për të provuar akuzën, ndërsa i pandehuri gëzon garancinë kushtetuese të prezumimit të pafajësisë. Kjo është arsyeja pse të provuarit e akuzës kërkon një analizë të hollësishme, të plotë dhe të gjithanshme të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, duke siguruar që të mos mbivlerësohet asnjëra prej tyre. Provat e paraqitura nga organi i akuzës, duhet t'i nënshtrohet, në kuptim të nenit 152 të K.Pr.Penale, shqyrtimit gjyqësor, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar, detyrim ky i cili rrjedh nga parimi-garanci i prezumimit të pafajësisë.

Një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale është ai i *“provave penale dhe procesit të të provuarit”*. Ky institut, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë që quhet procesi i zbulimit dhe i të provuarit të së vërtetës në procesin penal. Rëndësia e shqyrtimit dhe e verifikimit të provave gjatë gjykimit të çështjes është përcaktuese për formimin e bindjes së brendshme të gjykatës, mbi bazën e së cilës do të përcaktohet vërtetësia dhe fuqia e tyre provuese.

Ligjvënësi, në nenin 152/1 të K.Pr.Penale, ka parashikuar se: *“Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.”*

Nga interpretimi literal e gramatikor i kësaj dispozite, kuptohet një rregull i rëndësishëm i procesit të të provuarit, që çmuarja e provave bëhet vetëm mbi bazën e bindjes së brendshme, bindje kjo, e cila krijohet shkallë shkallë nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha provave. Në interpretim të nenit 152 të K.Pr.Penale, çmuarja e provave është procesi i

përcaktimit të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre, gjë që e bën gjykata. Bindja e brendshme, si e drejtë ekskluzive e atij që gjykon çështjen, formohet mbi bazë të provave të administruara në gjykim.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e çmon mënyrën, në të cilën trajtohen provat, si një çështje të rëndësishme në marrjen e vendimit, nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo. (*Çështja Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta, 18 mars 1977*).

Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 25, datë 15.01.2003 është shprehur: *“Përcaktimi i vërtetësisë së provës që është vënë si kusht nga ligjvënësi për të patur një proces ligjor çmuarje të saj, nënkupton...verifikimi se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çdo gjykim konkret, të cilin e përbëjnë përgjigjet që duhet t’u japë gjykata pyetjeve të tilla si: çfarë ka ndodhur, ku dhe kur ka ndodhur, me ç’mjet është kryer, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer veprën, përgjigje, të cilat duhet të përbëjnë shtratin mbi të cilin duhet ndërtuar pjesa arsyetuese e çdo vendimi gjyqësor në procesin penal”*.

Duke i parë këto parime dhe kritere të të provuarit të përcaktuara në K. Pr. Penale në lidhje me faktet dhe rrethanat e çështjes objekt gjykimi, provat kryesore në lidhje me fajësinë ose jo të të gjykuarit Xhulio Llaka informacion për referimin e veprës penale datë 09.07.2021; procesverbal i kapjes në flagrancë të shtetasit datë 09.07.2021; procesverbal për kallëzimin e veprës penale datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi nga ana e shtetasit Arben Mani datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi nga ana e shtetasit Xhavit Shabanaj datë 09.07.2021; procesverbal kqyrje dhe marrje prova shkresore datë 09.07.2021; procesverbal sekuestrimi prove materiale datë 09.07.2021; Vendim vleftësim sekuestro datë 11.07.2021; kontrolli banese datë 04.02.2021; procesverbal kqyrje automjeti datë 03.02.2021; procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Xhulio Llaka datë 09.07.2021; procesverbal mbi kontrollin personal të shtetasit Xhulio Llaka datë 09.07.2021; procesverbal deklarimi si person ndaj të cilit zhvillohen hetime për shtetasin Xhulio Llaka datë 09.07.2021 ; procesverbal i pyetjes së të pandehurit datë 19.07.2021 ; si dhe në tërësi aktet e procedimit penal nr. 5008 të vitit 2021.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në tërësinë e rrethanave të cituara më sipër, provohet plotësisht se, i pandehuri Xhulio Llaka me dashje, me veprimet e tij aktive të kundërligjshme në trajtën e dhënies së një kartmonedhe 2000 lekëshe në formën e mitës, për të shpëtuar nga masa administrative e gjobës, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, i pandehuri Xhulio Llaka ka qenë mendërisht i përgjegjshëm dhe mbi 14 vjeç në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale. Në këtë mënyrë, i pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale të kërkuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Sa më sipër Gjykata, bazuar në nenin 244/1 të K.Penal, e gjen fajtor të pandehurin Xhulio Llaka Igli Paskal për kryerjen e veprës penale të *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal.

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit, që duhet të vuajë i pandehuri Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh këto rrethana :

1. Rrezikshmërinë relativisht e ulët të veprës penale (pas ndryshimit) të *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar një dënim nga gjashtë muaj deri në një vit burgim.

2. Faktin se, i pandehuri e ka pranuar akuzën si gjatë hetimeve paraprake ashtu edhe gjatë gjykimit duke shprehur pendesë gjatë gjithë kohës.
3. Faktin se, i pandehuri është në moshë të re, me arsim të mesëm, dhe beqar.
4. Faktin se i pandehuri gjatë gjykimit ka qënë me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” çka tregon se, organi i akuzës ka vlerësuar se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët.
5. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore rezulton se, i pandehuri nuk është i dënuar më parë.

Nisur nga sa më sipër gjykata vëren se, rrethanat e mësipërme në kompleksitet, janë lehtësuese për të pandehurin Xhulio Llaka. Për pasojë, bazuar në nenet 47-50 dhe 290/3 të K.Penal Gjykata çmon se, dënimi i të pandehurit Xhulio Llaka me 6 (gjashtë) muaj burgim, për kryerjen e veprës penale të « *Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*», parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal do të arrijë qëllimin ndëshkues dhe edukues ndaj këtij të pandehuri dhe atë parandalues në shoqëri. Një masë dënimi e tillë është plotësisht e justifikueshme dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e tyre, të autorit dhe pasojave të ardhura në rastin konkret.

Për shkak se, ndaj të pandehurit gjykimi u zhvillua sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, bazuar në nenin 406 të K.Pr.Penale, masa e dënimit ulet me 1/3 (një të tretën) e tij dhe përfundimisht, i pandehuri Xhulio Llaka dënohet 4 (katër) muaj burgim. Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore të pandehurit.

Nisur nga rrezikshmëria e pakët shoqërore që paraqet i pandehuri dhe rrezikshmëria e pakët që paraqet vepra penale e kryer prej tij në këtë rast; nisur nga sjellja e mirë e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale; faktit se ai është i punësuar dhe me rrezikshmëri të ulët shoqërore Gjykata çmon se, izolimi i të pandehurit nga shoqëria do të sillte një dëm shumë të madh në jetën e të pandehurit dhe nuk do të ndihmonte në arritjen e qëllimit kryesor të dënimit : edukimin dhe rehabilitimin e tij.

Për pasojë, Gjykata çmon se, ka vend për aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe vendos pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit Xhulio Llaka, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 8 (tetë) muajsh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës në vendbanimin e tij. Në aplikim të nenit 60 pika 9 të K.Penal, i pandehuri gjatë periudhës së provës urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

Duke qënë se, i pandehuri është shpallur fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën u akuzua, në bazë të nenit 485 të K.Pr.Penale, duhet të paguajë shpenzimet gjyqësore të cilat i ngarkohen të pandehurit Xhulio Llaka.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata, bazuar në nenet 379, 384, 390, 406 e 485 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhulio Pëllumb Llaka**, për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 244/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht

i pandehuri **Xhulio Llaka** dënohet me **4 (katër) muaj burgim.**

3. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit **Xhulio Llaka**, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej **8 (tetë) muajsh** me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës në vendbanimin e të pandehurit.
4. Në aplikim të nenit 60 pika 9 të K.Penal, i pandehuri gjatë periudhës së provës urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
5. Shpenzimet gjyqësore hetimore në shumën 2000 (dymijë) lekë, shpenzimet gjyqësore në shumën 150(njëqind e pesëdhjetë) lekë (njoftime) si edhe 5000 (pesëmijë) lekë për mbrojtjen me avokat nga shteti, i ngarkohen të pandehurit.
6. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, më dt.05 tetor 2021!

SEKRETARE

GJYQTAR

JUNA SANXHAKU

GERD HOXHA